



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Lënda: Raport i monitorimit mbi performancën e produkteve/shpenzimeve për vitin 2024.

Në mbështetje të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr.10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Ligjit nr.97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, Udhëzimit nr.9 datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit”, Udhëzimit plotësues nr.1, datë 24.01.2024 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (këtej e tutje “Zyra e Komisionerit” ose KDIMDP), ka kryer monitorimin e buxhetit për vitin 2025), nëpërmjet vlerësimit të performancës së fondeve buxhetore dhe krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuara.

Monitorimi është procesi që lidh realizimin e objektivave dhe produkteve me fondet përkatëse të planifikuara për arritjen e tyre.

Vizioni i Zyrës së Komisionerit është promovimi i një shoqërie që mban si vlera thelbësore garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtës për informim, në funksion të transparencës, përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies.

Misioni ynë është monitorimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të kuadrit ligjor për të siguruar ushtrimin efektiv të të drejtave në epokën digjitale duke nxitur autoritetet publike dhe kontrolluesit publik e privat në ndërtimin e besimit reciprok me qytetarët, i cili sjell përmirësimin e mentalitetit dhe kulturës së shoqërisë në respektim të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

E drejta për informim është një e drejtë dhe liri themelore e qytetarëve, e cila shpreh pjesëmarrjen proaktive dhe kontrollin mbi veprimtarinë e autoriteteve publike. Transparenca është element kyç për një shoqëri demokratike, që ka në themel të saj qeverisjen e mirë, të hapur, të përgjegjshme dhe luftën kundër korrupsionit. Legjislacioni për të drejtën e informimit është në frymën e standardeve më të larta bashkëkohore dhe renditet si një nga më të mirët në botë.

Mbrojtja e të dhënave personale është një tjetër e drejtë dhe liri themelore e qytetarit, e cila shpreh individualitetin dhe dinjitetin e secilit prej nesh. Neni 35 i Kushtetutës, konventat ndërkombëtare të nënshkruara nga Shqipëria dhe ligjin nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, krijojnë shtratin rregullator si në sferën publike ashtu edhe në atë private për legjitimitetin e procesit të mbledhjes dhe përpunimit të tyre. Sot, zhvillimi i teknologjisë dhe digjitalizimi i shërbimeve është një proces i pakthyeshëm, duke ndikuar në rritje eksponenciale të përdorimit të të dhënave personale, e për rrjedhojë, mbrojtja e të tyre është domosdoshmëri.

Gjatë vitit 2024, veprimtaria e Zyrës së Komisionerit u ridimensionua drejt një bashkëpunimi të ngushtë ndërmjet autoriteteve publike dhe private, shoqërisë civile, qytetarëve dhe Zyrës së Komisionerit. Kontributi i institucionit për modernizimin e kuadrit rregullator, si pjesë e procesit të integritetit në BE, ishte domethënës dhe i vlerësuar brenda dhe jashtë vendit. Zyra e Komisionerit ka dhënë kontribute konkrete në kuadër të organizatave dhe forumeve ndërkombëtare ku ajo është anëtare edhe pse takimet dhe kontributi është dhënë nëpërmjet platformave online.

Fokusi i institucionit për vitin 2024, siç është përcaktuar edhe në Programin Vjetor të Punës, ka qenë :

- ✓ Miratimi i ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale” në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- ✓ Miratimi i akteve nënligjore në zbatim të legjislacioneve të reja sipas fushave të përgjegjësisë;
- ✓ Përmirësimi i kapaciteteve profesionale të stafit, me fokus të veçantë, thellimin e njohurive në funksion të përparimeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), si detyrime specifike që burojnë nga legjislacioni i përmirësuar;
- ✓ Bashkëpunimi me qytetarët dhe grupet e interesit në njohjen e risive rregullatore në të dy fushat, në ndërgjegjësimin për zbatimin e tyre;
- ✓ Monitorimi i vazhdueshëm i programeve të transparencës;
- ✓ Forcimi i kapaciteteve të stafit të Zyrës së Komisionerit mbi zbatimin efektiv të kuadrit të modernizuar ligjor.
- ✓ Ofrimi i mbështetjes praktike për autoritetet publike mbi zbatimin e kuadrit të ri rregullator të fushës.
- ✓ Komunikimi proaktiv me autoritetet publike për konsolidimin e kulturës së transparencës;
- ✓ Ndërgjegjësimi në funksion të transparencës proaktive, me qëllim uljen e ankesave dhe zbatimin e afateve ligjore në dhënien e informacionit
- ✓ Forcimi i rolit të koordinatorëve për të drejtën e Informimit nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme dhe mbështetjes teknike të Zyrës së Komisionerit, për trajtimin e çështjeve me interes publik në balancë me kufizimet për dhënien e informacionit;
- ✓ Përfshirja e sa më shumë autoriteteve publike në ofrimin e shërbimeve të kërkesës për informacion nëpërmjet procedurave elektronike, portalit e-albania dhe regjistrit elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve;
- ✓ Zhvillimi i hetimeve administrative *ex-officio* mbi zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, në autoritetet publike (qendrore e vendore), duke synuar rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në punën e autoriteteve publike ndaj qytetarëve;
- ✓ Ndërgjegjësimi i autoriteteve publike për qartësimin e çështjeve që kanë të bëjnë me transparencën, interesin publik, rastet e kufizimit të dhënies së informacionit publik, konfidencialiteti, etj;
- ✓ Monitorimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, me fokus, dhe veçanërisht, garantimin e sigurtisë teknike dhe organizative të të dhënave, si dhe krijimit, mirëmbajtjes dhe administrimit të SMSI për menaxhimin e sigurtisë së informacionit, për të realizuar dhe ruajtur konfidencialitetin, integritetin, disponueshmërinë dhe besueshmërinë e sigurtisë së informacionit, në kontrollues publik dhe privat;

- ✓ Përgjegjshmëri e lartë e kontrolluesve publik për t'iu drejtuar Zyrës së Komisionerit për dhënien e mendimeve mbi projektaktet ligjore/nënligjore, që në objekt të tyre kanë përpunimin e të dhënave personale;
- ✓ Forcimi i rolit dhe zgjerimi i rrjetit të nëpunësve për mbrojtjen e të dhënave personale në kontrolluesit publik dhe privat, si një detyrim që buron nga parashikimet e ligjit dhe që diktohet edhe nga përafrimi i legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. Ndërtimi i kanalit të komunikimit të nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave personale me Zyrën e Komisionerit, për mbikëqyrjen e brendshme të mbrojtjes së të dhënave personale duke kontribuar në zhvillimin e aktivitetit të kontrolluesve në përputhje me parashikimet e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale;
- ✓ Programimi i masave dhe zhvillimi i edicionit të 15-të të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit në Tiranë më 2024;
- ✓ Rol aktiv në kuadër të organizmave ndërkombëtare ku Zyra e Komisionerit është anëtare, si dhe me autoritetet homologe në të dy fushat e përgjegjësisë;
- ✓ Aplikimi për përfitimin e projekteve nga programe të asistencës nga fondet IPA të BE dhe/ose donatorë të tjerë, në funksion të rritjes së kapaciteteve profesionale;
- ✓ Monitorimi dhe mbikëqyrja e procesit të mbledhjes, përpunimit, shpërndarjes dhe shkëmbimit të të dhënave personale nga organet ligj zbatuese në kuadër të implementimit të detyrimeve ligjore në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Verifikimi i niveleve të dhënies së aksesit në të dhënat personale që përpunohen nga kontrolluesit nëpërmjet platformave në dispozicion, në përputhje me detyrimet ligjore sipas legjislacioneve specifike, në kuadër të garantimit të parimit të ligjshmërisë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale;
- ✓ Monitorimi mbi realizimin e detyrimeve në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale nga organet e prokurorisë, në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Republikës së Shqipërisë dhe *Eurojust*. Hartimi i Raportit vjetor në bashkëpunim me Oficerin e Mbrojtjes së të dhënave Personale në *Eurojust*.
- ✓ Përgjegjshmërisë së lartë të kontrolluesve publik për t'iu drejtuar Zyrës së Komisionerit për dhënien e mendimeve mbi projektaktet ligjore/nënligjore, që në objekt të tyre kanë përpunimin e të dhënave personale;
- ✓ Rolit aktiv për forcimin e kapaciteteve administrative (burime njerëzore dhe financiare) në kuadër të harmonizimit integral të legjislacionit në të dy fushat e përgjegjësisë;

Standardet bashkëkohore për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nuk mund të kuptohen pa një institucion të fortë e të plotësuar jo vetëm financiarisht. Kuadri i modernizuar ligjor për të dy fushat e përgjegjësisë ka shtuar së tepërmi kompetencat dhe funksionet mbikëqyrëse, çka solli domosdoshmërisht shtimin e kapaciteteve administrative për përmbushjen e tyre, si në terma sasiorë ashtu edhe cilësorë. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr.33/2022, Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “*Zyra e Komisionerit*”) i është shtuar edhe një tjetër kompetencë, duke u bërë institucioni përgjegjës për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtës për ripërdorim të dokumenteve, si dhe për procedurën e shqyrtimit të ankesave për moszbatimin e këtij ligji. Kjo Zyrë ushtron edhe funksione të tjera në procesin e njoftimit dhe konsultimit publik, monitorimit të sektorëve me

sensibilitet të veçantë apo që kanë të bëjnë me aspektet e integritetit dhe mirëqeverisjes, në bazë të kompetencave që i janë dhënë me ligje apo strategji të veçanta.

Në përdorimin e fondeve buxhetore, Zyra e Komisionerit është mbështetur në parimet e menaxhimit dhe mirëfunksionimit të sistemit buxhetor. Zyra e Komisionerit vijon të mbajë të njëjtin qëndrim lidhur me mospërfshirjen dhe plotësimin jo vetëm të PBA-së por edhe të moduleve të tjera në sistemin AFMIS, deri në marrjen e masave për përpunimin e të dhënave të përdoruesve gjatë autentifikimit në sistemin AFMIS, sipas rekomandimeve të dhëna nga KDIMDP.

Zyra e Komisionerit, edhe pse nuk është përfshirë në modulën e monitorimit në AFMIS ka përgatitur raportimin dhe vlerësimin e treguesve të performancës të synuar me treguesit faktik të realizuar, në zbatim të Udhëzimit të MFE nr. 14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes Qendrore”, në respektim edhe të sugjerimeve tuaja të konstatuara në raportimin Janar-Gusht 2024.

Produkti i vetëm i Programit 0110, në shpenzime operative është **Mbikëqyrje/inspektime të kryera & ankesa të trajtuara**, ku parashikimi është **nr. 1840 veprime**

E drejta e informimit :

➤ Autoritetet Publike me programe dhe transparencë të plotë

Sigurimi i Transparencës së veprimtarisë së Autoriteteve Publike, nëpërmjet realizimit të proceseve të monitorimit/mbikëqyrjes së elementëve të ndryshëm të zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit, të autoriteteve publike etj

➤ Trajtim i ankesave brenda afateve dhe (kthim përgjigje/inspektime/vendime, kryesisht në bazë të ankesave).

Ankesa të trajtuara në kuadër të parashikimeve të Ligjit “Për të Drejtën e Informimit” si dhe Ligjit “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, hetime të kryera, seanca dëgjimore të zhvilluara si dhe vendime të dhëna etj

Mbrojtja e të dhënave personale

➤ Mbikëqyrje dhe inspektime.

Nëpërmjet procedurave për realizimin e këtij produkti do të bëhet e mundur minimizimi i rrezikut të cënimit të privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale; Ndërgjegjësimi dhe disiplinimi i kontrolluesve; Krijimi i praktikës së mirë për kontrolluesit.

➤ Ankesa të trajtuara

Trajtimi në kohë i ankesave të ardhura nga subjektet e të dhënave personale, në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale etj

Zyra e Komisionerit ka ngritur sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, i cili është mbështetur në Ligjin nr.10296, datë 8.07.2010 “Mbi menaxhimin financiar e kontrollin”,

i ndryshuar si dhe në parimet e menaxhimit të fondeve publike me efektivitetet, transparencë, ekonomi dhe efikasitet.

Në mbështetje të Ligjit nr.97/2023“Për buxhetin e vitit 2024”, dhe në vijim të udhëzimeve të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.07.2018, “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar dhe Udhëzimit plotësues nr.1, datë 24.01.2024 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”, fondet e akorduara për Zyrën e Komisionerit, janë rishikuar me akte normative, ku vlera në total rezulton 160.055 (mijë lekë). Struktura e elementëve buxhetorë paraqitet si më poshtë:

Llog. Ekonomike	Përshkrimi	Plani i buxhetit për vitin 2024, i ndryshuar (në mijë lekë)
600	Fond Page	92.140
601	Kontrib. Sig. Shoq & Shënd.	16.330
602	Mallra dhe shërbime të tjera	32.790
605	Transferta korente jashtë vendit	130
606	Transf. për Buxh. Fam. & Individ	310
230-231	Shpenzime kapitale	18.000
	Paisje zyre, elektronike/kompjuterike	18.000
		159.700
606	Fondi i vecantë	355
	T o t a l i	160.055

Vlera e mbartur nga viti 2024, sipas artikujve buxhetore, me burim financimi donacionet/sponsorizimet paraqitet për sa e si më poshtë:

- 1- Shpenzime operative në vlerën 3.579.570 lekë
- 2- Shpenzime kapitale në vlerën 17. 370.119 lekë

Gjatë periudhes se raportimit është përdorur fondi në shpenzime operative në vlerën prej 2.619.000 lekë.

1. Realizimi i Treqesve ekonomiko-financiare

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor janë shpenzuar 154.204 (në mijë lekë), me realizim përkundrejt planit vjetor në masën 96 %

Tabela e mëposhtme pasqyron në %, çdo kategori shpenzimesh, përkundrejt totalit të buxhetit, si dhe realizimi në % dhe vlerë, i secilës kategori shpenzimesh, përkundrejt buxhetit të akorduar, te ndryshuar

TABELA E AKORDIMIT TË BUXHETIT DHE REALIZIMIT (i ndryshuar)**Janar–Dhjetor****000 / lekë**

Nr.	EMËRTIMI	PLAN VJETOR 2024	PËRQINDJE KUNDREJT TOTALIT	FAKT vjetor	PËRQINDJE REALIZIMI KUNDREJT PLANIT VJETOR
1	Paga	92.140	57.5 %	91.651	99 %
2	Sigurime shoqërore	16.330	10.2 %	14.413	88 %
3	Mallra e shërbime të tjera	32.790	20.5 %	31.089	95 %
4	Investime	18.000	11.2 %	16.362	91 %
5	Transferta te buxhetet familjare	310	0.1 %	287	85 %
6	Kuotizacion	130	0.08 %	111	85 %
	Totali	159.700		153.913	96 %
7	Fondi i vecantë	355	0.5 %	291	0
	Totali final	160.055	100	154.204	96 %

○ **Fondi i përgjithshëm i pagave si dhe i sigurimeve shoqërore.**

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor i planifikuar për vitin 2024, për periudhën e raportuar Zyra e Komisionerit ka shpenzuar **vlerën buxhetore 106.064 (në mijë lekë)**. Është realizuar buxheti për periudhën Janar- Dhjetor në masën 97.7 %, kundrejt planit vjetor Fondi i përgjithshëm i pagave si dhe i sigurimeve shoqërore, është realizuar për numrin faktik të punonjësve në strukturë dhe jashtë saj (52 +5).

Struktura dhe organigrama e kësaj Zyre, ka ndryshuar me Vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 24/2023 “Për disa shtesa e ndryshime në Vendimin nr. 86/2018 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, i cili ka 60 punonjës. Mosrealizimet për këtë periudhë kanë ardhur për shkak të krijimit të vendeve vakante si pasojë e hyrjes në fuqi të strukturës së re me 60 punonjës, në janar 2024 si dhe të larguarve për arsye të ligjshme. Referuar planit vjetor të rekrutimeve janë finalizuar rreth 8 procedura rekrutimit, ndërsa kemi në vijim procedurat e tjera deri në plotësimin e vendeve vakante.

- **Fondi për Shpenzime Korente të tjera (602-606)**, për periudhën Janar-dhjetor 2024, është realizuar në vlerën **31.778 (në mijë) lekë**, ose rreth 96 % e fondit të planifikuar vjetor, të ndryshuar, të këtij shpenzimi (602-606). Ky fond është realizuar për:

- Shlyerjen e detyrimeve ndaj shtetit, si detyrime energji elektrike, ujë, shërbime bankare, postare e telefonike.
- Shpenzime në funksion të realizimit të qëllimit të Komisionerit, ku për platformat e instaluar janë ndërmarrë procedurat e mirëmbajtjes vjetore të tyre
- Shpenzime për sigurimin e godinave e të mjeteve të transportit
- Shpenzime të tjera mirëmbajtje/furnizime, e të tjera shërbime bazë të funksionimit
- Shpenzime për mbulimin e organizimit të aktivitetit më i rëndësishëm botëror për nxitjen e kulturës së transparencës dhe përgjegjshmërisë së autoriteteve publike, Konferenca e XV Ndërkombëtare e Komisionerëve të Informimit, e cila u mbajt në Tiranë, në datat 3-5 qershor 2024
- Shpenzime për mbulimin e organizimit të aktivitetit në nivel Kombëtar Konferenca e VI Kombëtare *“E Drejta për Informim - Ndërtimi i besimit - Promovimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit në politikat kundër korrupsionit”*.
- Shpenzime administrative për mbulimin financiar të aktiviteteve të shtuara, si rezultat i funksioneve dhe kompetencave të Zyrës së Komisionerit, në të dy fushat e përgjegjësisë, por edhe për shkak të rëndësisë dhe intensitetit të takimeve jashtë vendit në kuadër të procesit të integritetit evropian.

Gjatë kësaj periudhe raportimi janë zhvilluar 44 procedura prokurimi të gjitha të suksesshme me fitues dhe plotësim kërkesash.

Fondi për shpenzime investime (zëri 231), me ligjin nr. 97/2023 “Për Buxhetin e vitit 2024”, Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është alokuar fondi i investimeve

- Në projektin M890002 “Blerje pajisje Kompjuterike”, në vlerën **18.000.000 lekë**,

Për këtë projekt u realizua procedura e prokurimit elektronik, duke shpallur fituesin, lidhur kontratën dhe realizuar ofrimin e pajisjeve me fondet e vitit 2024 e në vijim për vitin 2025.

Fondet e realizuara për vitin 2024 janë në masën 16.362.000 lekë, duke arritur të sigurohen Pajisjet Kompjuterike/implementimi i infrastukturës së qendëruar *hardware* për nevojat e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, ndërsa kontrata do të jetë në vazhdim e obliguar, në vlerën 10.584.000 (dhjetë milion e pesëqind e tetëdhjetë e katër mijë) lekë me TVSH, për “Shërbimin e mirëmbajtjes”, për 3 vjet ose 36 muaj – financuar nga Buxheti i Shtetit për vitet 2025-2027 në shpenzime operative.

Në Aneksin nr. 3 është paraqitur realizimi i treguesve të performancës/produkteve (në sasi dhe vlerë) në zbatim të objektivave për vitin 2024.

Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, është kryer nëpërmjet monitorimit të elementëve të ndryshëm të ligjit si p.sh. numri i autoriteteve publike që kanë hartuar programet e transparencës, koordinatorë të caktuar nga autoritetet publike, përditësimi i regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, numri i ankesave të shqyrtuara, hetimet e kryera, seanca dëgjimore të zhvilluara si dhe vendimet e dhëna. Produktet kryesore janë:

Nënprodukti A: Trajtim i ankesave brenda afateve (kthim përgjigje/inspekte/vendime, kryesisht në bazë të ankesave (i ndryshuar), rreth 1100+-)

Zyra e Komisionerit ka realizuar monitorimin e zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit, duke shqyrtuar jo vetëm ankesat e depozituara, por duke kryer gjithashtu inspekte, seanca dëgjimore si dhe duke marrë vendime urdhërimi apo sanksionimi sipas ligjit për rastet kur është konstatuar refuzim i padrejtë i vënies në dispozicion të informacionit.

Drejtoria e Vlerësimit të Ankesave pranë Drejtorisë së Përgjithshme të së Drejtës për Informim në Zyrën e Komisionerit për vitin 2024 administroi 939 ankesa, si dhe vijoi me shqyrtimin administrativ të 86 procedurave të mbartura nga viti 2023 (gjithsej 1025 ankesa). Këto shifra tregojnë rënie të lehtë të numrit të ankesave për 2 vitet e fundit, që mund të lidhet dhe me tendencën e përmirësimit të transparencës proaktive të autoriteteve publike.

Konkretisht, ndaj NJVV u depozituan 332 ankesa dhe ndaj AP të tjera 607 ankesa. Rezulton se edhe për këtë vit raportues pesha specifike e ankesave për mosdhënie të informacionit vijon të anojë nga NJVV në raport me AP e tjera.

Nga totali prej 1025 ankesash, për 623 prej tyre informacioni/dokumentacioni i kërkuar u është vënë në dispozicion ankuesve, pas ndërhyrjes së Zyrës së Komisionerit. Këto praktika konsiderohen të përmbushura me ndërmjetësim, si një nga mënyrat më efektive të realizimit të qëllimit të LDI.

Ndërkohë, institucioni është shprehur me 23 vendime për 23 ankesa. Nga këto vendime, janë dhënë 11 vendime urdhërimi për dhënie informacioni, 5 vendime rrëzimi, 2 vendime mospranimin dhe 4 vendime me sanksion administrativ gjobe.

Me ndryshimet e LDI, Zyra e Komisionerit ka dalë me 1 vendim për moszbatim vendimi duke sanksionuar titullarin e një AP për mos zbatimin e vendimit të Komisionerit.

Në zbatim të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, Zyra e Komisionerit ka vijuar punën për mbikëqyrjen dhe garantimin e të drejtës për akses në informacion publik, duke u mbështetur në vendosjen e balancës dhe respektimin e parimit të proporcionalitetit.

Nga sa konstatuar më sipër në mbi 61 % të ankesave të trajtuara është dhënë zgjidhje dhe qytetari ka marrë dhe përfituar të drejtën e tij.

Në tërësi Nënprodukti A: 1043 (1025 ankesa të trajtuara + 23 vendime) realizuar rreth 95 % të planifikimit vjetor

Nënprodukti B- Monitorim i Autoriteteve Publike me programe transparencë planifikuar (380 +-monitorime) .

Gjatë vitit 2024, ka pasur një shtim të numrit të autoriteteve publike, krahasuar me një vit më parë, për shkak të ristrukturimit të një pjese prej tyre e veçanërisht për sa i përket shoqërive aksionare të ujës-jellës kanalizimeve të cilat janë instruktuar, si dhe disa autoritete publike të reja të krijuara me ligj.

Nisur nga fakti se gjatë vitit 2024 janë identifikuar autoritete publike të krijuara rishtazi, Zyra e Komisionerit ka vendosur në fokus të punës për vitin 2024, monitorimin e transparencës proaktive edhe në këto autoritete. Konkretisht, Komisioneri ka dalë me 25 Rekomandime lidhur me vënien në zbatim dhe publikimin/përditësimin e informacionit në Programin e Transparencës të këtyre institucioneve, të cilat mund të konsultohen në faqen zyrtare <https://idp.al/rekomandime-2024-ddi/>.

Në total gjatë vitit 2024 janë monitoruar 363 autoritete publike Në total gjatë vitit 2024 janë monitoruar 363 autoritete publike ku rezulton se të gjitha kanë caktuar koordinatorin për të drejtën e informimit dhe të dhënat e koordinatorëve janë përditësuar dhe në portalin pyetshtetin.al.

Zyra e Komisionerit përveç kryerjes së monitorimeve online, ka zhvilluar gjithashtu edhe hetime administrative pranë këtyre institucioneve publike. Konkretisht, gjatë këtij viti janë zhvilluar 15 procese hetimi administrativ me objekt: *Konstatimin e kundërvajtjes për mungesën e krijimit, mbajtjes, publikimit apo përditësimit të Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve*. Në konkluzion të procedurave të mësipërme administrative, për ato autoritete publike të cilat nuk kishin marrë masa për përmbushjen e detyrimeve të mësipërme ligjore, ose nuk kishin njoftuar Zyrën e Komisionerit për pengesa të qenësishme në mospërmbushjen e këtij detyrimi, me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, Komisioneri vlerësoi zhvillimin e 12 seancave dëgjimore. Në përfundim të procesit të hetimit administrativ dhe rimonitorimit, rezultoi se 4 autoritete publike nuk arritën të përmbushin detyrimin ligjor. Për këtë arsye, Zyra e Komisionerit doli me **4 vendime urdhërimi** për krijimin, mbajtjen, bërjen publike dhe përditësimin e Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve, si dhe u dha **sanksion administrativ “gjobë”** për personat përgjegjës sipas përcaktimit ligjor.

Gjatë këtij viti, Zyra e Komisionerit ka zhvilluar dhe **12 inspektime** pranë autoriteteve publike

Implementimi i ligjit nr.33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”.

Në zbatim të ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik” Zyra e Komisionerit dhe Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe

Inovacionit, si dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit kanë hartuar draft udhëzimin “Për licencën standarde për ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, licencë e cila do të shoqërojë të dhënat e hapura të publikuara nga organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike në RSH.

Për këtë periudhë, Zyra e Komisionerit ka bashkëpunuar me organet e sektorit publik për ndërgjegjësimin e tyre për zbatimin e ligjit nr. 33/2022 "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik". Gjatë muajve janar-qershor 2024 janë dërguar gjithsej 214 shkresa zyrtare, nga të cilat 153 drejtuar organeve të sektorit publik (OSP) dhe 61 shkresa drejtuar bashkive me qëllim publikimin e "Listës së dokumenteve ekzistuese që mund të ofrohen në formatin e të dhënave të hapura".

Pjesë e këtij procesi është edhe asistenca e vazhdueshme nga ana e Sektorit për të Dhënat e Hapura dhe Konsultimin Publik, ndaj organeve të sektorit publik lidhur me implementimin prej tyre të ligjit nr. 33/2022.

Zyra e Komisionerit, në zbatim të detyrimeve të ligjit nr. 33/2022 "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik" (neni 7 pika 3) ka publikuar në faqen e tij zyrtare “Listën e të dhënave të hapura të KDIMDP”.

Gjatë periudhës janar - dhjetor 2024 janë administruar 2 ankesa referuar ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, nga të cilat një ankesë është konsideruar jashtë fushës së veprimit të këtij ligji. Lidhur me këtë ankesë është zhvilluar edhe një takim konsultativ me palën ankuese. Ankesa e dytë, pas shqyrtimit të saj referuar parashikimeve ligjore është konsideruar “jashtë afatit” pasi ishte bërë në tejkalim të afatit të parashikuar në ligjin nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Produktet e kësaj komptence do të përfshihen gjatë vitit 2025.

Nënprodukti B: Janë monitoruar (363 + 15 hetime + 12 inspektime të AP), mbi 100 % të produktit

➤ **Të tjera aktivitete në funksion të rritjes së transparencës**

❖ **Kërkesa nëpërmjet regjistrit**

Me qëllim zbatimin e detyrimeve, që burojnë nga LDI, si dhe duke synuar bërjen sa më efektive të së drejtës për informim si një e drejtë kushtetuese dhe një mjet për garantimin e llogaridhënies së autoriteteve publike, Zyra e Komisionerit ka ngritur “Regjistrin elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit” (REKPDI), parashikuar në nenin 8 të LDI. Regjistri elektronik i kërkesave dhe përgjigjeve për vitin 2024 është instaluar **në 25 autoritete publike**, duke e çuar në **247 numrin total të autoriteteve që kanë instaluar regjistrin elektronik**. Koordinatorët e këtyre 25 autoriteteve janë trajnuar në dy trajnime të posaçme nga Zyra e Komisionerit, lidhur me mënyrën e funksionimit të REKP-i, por edhe me detyrimet ligjore që burojnë nga LDI.

❖ Aktivitete të tjera mbështetëse.

Zyra e Komisionerit ka përmbushur raportimin vjetor në Strategjinë Ndërsektoriale Zyra e Komisionerit ka përmbushur raportimin vjetor në Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, si dhe raportimet për progresin e “Udhërrëfyesit për Reformën në Administratën Publike”, në Paketën e Semestrit të Integritimit Evropian (PSIE) për vitin 2024, për Kapitullin 10 si dhe hartimin e Pozicionit Negociues për Clusterin 3, pjesë e të cilit është edhe Kapitulli 10. Gjithashtu, është dhënë kontribut mbi komponentët e asistencës teknike të përfituar në kuadër të IPA Good Governance 2020 “Për mirëqeverisjen”.

Gjithashtu, gjatë periudhës janar – dhjetor 2024, Zyra e Komisionerit ka vijuar me angazhimin dhe kontributin e saj në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar ku ka marrë pjesë në 5 takime online të Komitetit Ekzekutiv të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit, në cilësinë e anëtarit që prej vitit 2021.

Edicioni XV i Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informacionit u organizua nga Zyra e Komisionerit, në datat **3 deri më 5 qershor**, si aktiviteti më i rëndësishëm në fushën e aksesit në informacion dhe promovimit të transparencës dhe llogaridhënies së autoriteteve publike. Gjatë 3 ditëve të konferencës morën pjesë mbi 200 përfaqësues të shteteve/juridiksioneve anëtare të ICIC ose vëzhgues nga të gjitha kontinentet, organizata ndërkombëtare si Këshilli i Evropës, UNESCO, Banka Botërore dhe OECD, akademi, shoqëria civile dhe media, në nivel lokal dhe ndërkombëtar. Ky event ofroi një platformë të vlefshme për shkëmbimin e njohurive, diskutimin e praktikave më të mira dhe inkurajimin e bashkëpunimit dhe bashkëpunimit.

Ndërkohë Zyra e Komisionerit dhe Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin (MAPA), në datën 26 qershor 2024, bashkëorganizuan **Konferencën e VI Kombëtare për të Drejtën e Informimit me temën me temën “Ndërtimi i besimit: Promovimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit në politikat kundër korrupsionit”**, qershor 2024. Fokusi i këtij aktiviteti ishte roli i domosdoshëm i shoqërisë civile dhe medias në promovimin e së drejtës për akses në informacionin publik dhe forcimin e transparencës, për ngritjen e institucioneve përgjegjëse si dhe shkëmbimin e praktikave më të mira, forcimin e llogaridhënies, si një shtyllë e parandalimit. qasjen e politikave antikorrupsion.

Me propozim të Komitetit Ekzekutiv në mbledhjen e 6-të plenare të tij në dhjetor 2024, Zyra e Komisionerit u propozua që të marrë përkohësisht funksionet dhe rolin e **Presidencës-Sekretariati të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC)**. Ky është një vlerësim për Zyrën e Komisionerit për profesionalitetin e treguar në organizimin e suksesshëm të Konferencës së ICIC në 2024 në Tiranë, si edhe për kontributin dhe rolin aktiv në bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e aksesit në informacion. Ky funksion i përkohshëm do të zgjasë **deri në qershor 2025** në konferencën e Berlinit.

Për periudhën janar - dhjetor 2024, Zyra e Komisionerit ka marrë pjesë dhe organizuar shumë takime e trajnime, përfaqësime brenda e jashtë vendit, të cilat do ti gjeni të

evidentuara gjerësisht në raportin vjetor 2024, por të publikuara edhe në faqen zyrtare www.idp.al

MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

➤ **Nënprodukti C: Mbikëqyrje dhe inspektime, i ndryshuar, (Inspektime mbi bazë ankese dhe kryesisht +-60),**

Gjatë vitit 2024, kemi ushtruar hetime administrative në kontrollues publikë dhe privatë, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së tyre përpunuese në raport me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në total, u zhvilluan 77 hetime administrative, prej të cilave 10 mbi bazë ankese dhe 67 me iniciativën e Zyrës së Komisionerit (*ex-officio*). Sa i përket sferave të veprimtarisë, 44 procese hetimi administrativ u ndërmorën në kontrollues publikë dhe 33 në kontrollues privatë.

Gjatë vitit 2024, janë ushtruar **11 hetime administrative** në kuadër të verifikimeve të zbatimit të 34 rekomandimeve të dhëna në periudhën 2022-2024, si në sferën publike ashtu edhe në atë private. Në tërësi konstatohet se një numër i konsiderueshëm i kontrolluesve kanë përmbushur detyrimet ligjore, plotësisht dhe në afatet e përcaktuara, çka përbën tregues të ndërgjegjësimit në rritje për mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve. Në përfundim 8 kontrolluesve u është vendosur sanksion administrativ, për mospërmbushje të detyrimeve të lëna në Rekomandimet e mëparshme, të tilla si, marrja e masave për përpunimin e ligjshëm të të dhënave, garantimi i të drejtave të subjekteve të të dhënave, marrja e masave të përshtatshme teknike dhe organizative për sigurinë e të dhënave, etj

Në bazë të kompetencave që Komisionerit i burojnë nga legjislacioni për masat shpesh të sigurisë publike dhe legjislacioni për kontrollin kufitar sa i përket të dhënave të pasagjerëve PNR/API, u zhvilluan 2 hetime administrative, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Njesisë së Informacionit të Pasagjerit.

Në qendrat dhe organizatat pritëse të viktimave të trafikimit (OJF), u zhvilluan 2 hetime administrative, mbi zhvillimin me përgjegjshmëri të proceseve të përpunimit të të dhënave personale. Në përfundim të tyre, Komisioneri ka dalë me 2 Rekomandime.

Zyra e Komisionerit, me qëllim monitorimin/mbikëqyrjen dhe zbatimin e detyrimeve ligjore i është drejtuar me shkresë lidhur me *zbatimin e detyrimeve të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale*”, **45 kontrolluesve publik**, ku ndër pyetjet kryesore lidhen me masat e sigurisë teknike-organizative, aksesit i databazave, marrja e masave për krijimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e SMSI, ndërveprimi i sistemeve, trajnimet, etj.

Nga deklaratimet e **32** institucioneve publike, në cilësinë e kontrolluesve, Zyra e Komisionerit vlerëson se problematikat e konstatuara në institucionet e administratës shtetërore, lidhen me mungesën e njohurive ligjore dhe teknike mbi detyrimet që parashikon legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në zbatim të detyrimeve ligjore, për qartësimin e rrethanave dhe fakteve në lidhje me të gjitha proceset administrative të kryera, u zhvilluan 37 seanca dëgjimore me pjesëmarrjen e palëve. Seancat dëgjimore janë zhvilluar në respektim të të drejtës së subjekteve për t'u dëgjuar në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Në shifra përmbledhëse, për vitin 2024 Komisioneri u shpreh me:

- 17 Rekomandime Specifike dhe 3 Rekomandime Unifikuese;
- 16 Vendime;
- 2 Urdhra (*për korrigjimin e të dhënave personale*);
- 9 Raporte Monitorimi.

➤ **Dhënie mendimi për projektligje/projektvendime/Opinione ligjore**

Zyra e Komisionerit ka dhënë mendime ligjore për;

- 4 projekt-vendime;
- 5 projekt-ligje;
- 1 draft metodologji;
- 25 opinione ligjore të paraqitura nga kontrollues publik e privat.

➤ **Transferimi ndërkombëtar**

Zyra e Komisionerit ka trajtuar 12 raste kërkesash për transferim ndërkombëtar të të dhënave personale, drejt vendeve që nuk kanë një nivel adekuat të mbrojtjes së të dhënave. Në çdo rast, kontrollorët janë udhëzuar për zbatimin e plotë të kuadrit rregullator për të garantuar përpunimin e drejtë dhe të ligjshëm të të dhënave personale të individëve, kur kërkohet kryerja e këtij procesi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Pas vlerësimit, është dalë me 1 vendim për lejimin e transferimit ndërkombëtar në sektorin bankar.

➤ **Njoftimi/regjistrimi i kontrolluesve**

Gjatë vitit 2024, në përmbushje të detyrimit ligjor kanë njoftuar për përpunimin e të dhënave personale 53 subjekte kontrolluese të reja. Gjithashtu, u regjistruan deklaratat e 35 kontrolluesve për ndryshim të gjendjes së njoftimit të përpunimit të njoftuar më parë. Numri i subjekteve kontrolluese të regjistruara në Regjistrin i Subjekteve Kontrolluese në total është 6007

Nënprodukti C: (Inspektive mbi bazë ankese dhe kryesisht +- 60), janë realizuar 98, pa përfshirë veprime të tjera vendime, rekomandime, sanksione, urdhërime duke realizuar mbi 100 % të numrit të planifikuar

-Nënprodukti D. Ankesa të trajtuara (nr.rreth +- 300),

Gjatë vitit 2024, janë trajtuar 455 ankesa nga qytetarë/subjekte të të dhënave, në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale.

Synimi kryesor i hetimeve administrative ka qenë zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.

Bazuar në këto të dhëna, rezulton se për këtë vit, numri i ankesave 455 të ardhura në adresë të Komisionerit është në trend të ndjeshëm rritës, krahasuar me një vit më parë, ku u regjistruan 394 ankesa çka tregon për rëndësinë që po i kushtojnë individët kontrollit dhe mbrojtjes së të dhënave të tyre personale. Lidhur me ankesat janë zhvilluar 10 hetime administrative.

Nënprodukti D: Ankesa të trajtuara, pa përfshirë vendime, rekomandime, insoektive është realizuar nga ana sasiore 455 ankesa, nga 300 të planifikuara ose mbi 100 % e planifikimit

❖ Aktivitete të tjera mbështetëse

Zyra e Komisionerit, me rastin e 28 Janarit, bashkëpunoi me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS), Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP) dhe strukturat e saj të varësisë për zhvillimin e aktiviteteve ndërgjegjëse në disa shkolla të mesme të përgjithshme në vend.

Gjatë kësaj periudhe kanë qenë të shumta takimet brenda apo jashtë vendit, për zbatimin e detyrimeve ligjore brenda fushës së përgjegjësisë, të financuar nga Buxheti i shtetit. Të gjitha aktivitetet do të listohen në Raportin vjetor 2024, ndërkohë të gjithë aktivitetin e Zyrës së Komisionerit e gjeni të publikuar në faqen zyrtare www.idp.al

Një tjetër aktivitet që mbështet të dy shtyllat për garantimin e dy të drejtave **është Shërbimi ligjor**.

Gjatë vitit 2024 janë evidentuar realizimet për proceset si më poshtë:

Hartimi i dokumenteve

- Hartimi i Raportit Vjetor 2023, koordinimi me strukturat e institucionit dhe institucionet përgjegjëse për miratimin e tij;
- Hartimi i draft – rezolutës në bashkëpunim me strukturat e institucionit dhe koordinim me strukturat e Kuvendit për dakortësimin me qëllim finalizimin e saj;
- Hartimi i Programit të Punës për vitin 2024 të Zyrës së Komisionerit dhe finalizimit të Rregullores së Brendshme të institucionit;
- Ndjekja e procesit të vlerësimit të OECD/SIGMA për Shqipërinë për vitin 2024, koordinimi me strukturat e institucionit për përgatitjen e përgjigjeve, koordinim me

- ekspertët e SIGMA për takime të kërkuara në këtë kuadër si dhe hedhja në sistemin PAR.IS të përgjigjeve për fushën e përgjegjësisë së institucionit;
- Ndjekja e procesit të auditimit të KLSH pranë Zyrës së Komisionerit për periudhën 2021-2023, koordinimim me strukturat e institucionit dhe KLSH gjatë periudhës së auditimit, si dhe për përgatitjen e observacioneve të akt-konstatimeve të lëna;
 - Është hartuar Raporti i Monitorimit mbi “Zbatimin e Planit të Integritetit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për vitin 2023”;
 - Hartimi i ToC, të rishikuara (shqip dhe anglisht për GDPR dhe Direktivën e Policisë) për projektligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”; rishikimi i RIA dhe relacionit të projektligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;
 - Është dhënë kontribut mbi hartimin e kontratave të sponsorizimit dhe shërbimit për organizmin e “Edicionit të 15-të të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC) në Tiranë”;
 - Është përditësuar dhe miratuar Aneksi nr.1 i Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe Komisionerit nr. 463/2020;
 - Është hartuar Draft/Udhëzuesi për “Pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit”.
 - Përgatitja e masave që do të marrë Zyra e Komisionerit (për periudhën 2024-2030) për zbatimin e rekomandimeve të lëna në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës - Kapitulli 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore” si dhe koordinimi me Ministrinë e Drejtësisë për finalizimin e tij për Seksionin “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe “Të Drejtat Themelore” – Kuadri i Përgjithshëm”;
 - Koordinimi i grupit të punës së ngritur me qëllim hartimin e draft – udhëzimit të përbashkët të Komisionerit dhe MEKI për modelin e “Licencës standarde”, në zbatim të ligjit për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik, hartimi i draft - udhëzimit dhe dokumenteve bashkëlidhur tij;
 - Shumë aktivitete e raportime do të gjeni në raportin vjetor 2024.

Dhënie mendimi/opinione ligjore

Qasja konstante e Zyrës së Komisionerit për harmonizimin e kuadrit rregullator kombëtar me atë të mbrojtjes së të dhënave personale, nuk është vetëm një detyrim ligjor, por një praktikë e rëndësishme që ndikon në garantimin e kësaj të drejte themelore nga kontrolluesit (institucione/organe) publik.

Gjatë vitit 2024, u dhanë mendime për **32** akte rregullative përfshirë **11** projektligje, **20** projektvendime, **1** draft metodologji, si dhe **40** opinione për çështje/projekte të paraqitura nga kontrollues publik apo privat. Gjatë viteve të fundit shifrat flasin për ndërgjegjësimin në rritje të kontrolluesve publik lidhur me përputhjen e legjislacionit specifik me atë të mbrojtjes së të dhënave personale, kur në objekt të tyre këto akte kanë edhe procese përpunuese.

Kjo veprimtari është udhëhequr nga fryma e zbatimit të standardeve të GDPR në legjislacionin shqiptar, ku parimet e përgjegjshmërisë, integritetit, konfidencialitetit apo i sigurisë së të dhënave kanë qënë fokus kryesor në këtë drejtim. Siç tregohet edhe në tabelën e mëposhtme, gjatë viteve të fundit shifrat flasin për ndërgjegjësimin në rritje të

kontrolluesve publik për përputhjen e legjislacionit specifik me atë të mbrojtjes së të dhënave personale, kur në objekt të tyre këto akte kanë edhe procese përpunuese.

-Të ardhurat nga sanksionet/gjoha

Për vitin 2024 sanksionet administrative të vendosura, janë në shumën **3 800 000** lekë. Ekzekutimi i sanksioneve arkëtohet 100% në buxhetin e shtetit, duke u shlyer vullnetarisht ose nëpërmjet shërbimit përmbarimor. Për vitin 2024, shuma totale e arkëtimit të sanksioneve administrative është 1 565 000 lekë, e cila ndahet në 190 000 lekë për sanksionet e vendosur në vitin 2024 dhe vlera 1 375 000 lekë për sanksionet e mbartura nga vitet paraardhëse.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi